



RisiAlbania

Partner for Growth

*Historia frymëzuese e Dorinelës
Midis sfidës personale dhe profesionale!*

Dorinela Bushpreni



“A ishte pjesëmarrja tek “Më i Miri në Vend” një pikënisje e një jete që unë doja, dhe a vazhdova më pas?

Absolutisht që po” - thotë Dorinela, e cila kujton me emocion te veçantë se gjatë xhirimeve ishte në pritje të ëmbël dhe pavarësisht sakrificave dhe lodhjes ajo kishte dëshirën dhe këmbenguljen për të qenë një sfidante e denjë. Ajo konkurroi në programin mediatik “Më i Miri në Vend” një format televiziv që vendos në garë të rinj dhe të reja në sektorin e shërbimeve, ku gjatë edicionit të 2021 ku ishte pjesëmarrëse edhe Dorinela, fokusi ishte në profesionet e Hotelierisë. Programi synon orientimin në karrierë të të rinjve duke prezantuar në format tërheqës, profesione të kërkuara në treg, dhe me mbështetjen e ekspertëve të fushës ofron informacion të përditësuar dhe relevant mbi sektorin. Dorinela, garoi në profesionin e Menaxheres së Marketingut dhe ishte në garë me dy konkurrentë të tjerë. Në ditën e tyre të punës dhe në sfidën e madhe, Dorinela arriti të rrëmbente pikët maksimale duke u shpallur fituesja e këtij profesioni.



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim DSC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim DSC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



"Pjesëmarrja ime tek "Më i Miri në Vend", erdhi si një ftesë nga Akademia e Hotelierisë dhe Turizmit (HAT), shkolla në të cilën po ndiqja kursin Hotelier në atë kohë, veçanërisht nga përkrhësja ime më e madhe Gladiola, përsa i përket zhvillimit tim profesional në industrinë më të bukur në botë, atë të Mikpritjes dhe Turizmit".

Nuk hezitoi të thoshte "PO", dhe ndiej më shumë se gati për një sfidë me profesionistë të tjerë të fushës. E sigurtë në vetvete ajo kujton se: "Duke qenë një njeri që e di gjithmonë se çfarë do nga vetja, tashmë isha bërë pjesë e xhirimeve. Isha një nga konkurrentet e emisionit dhe përveç kupës që synoja, mbi shpatulla kisha dhe një peshë tjetër. Pjesëmarrja në një garë profesioni për mua nuk do mbetej me aq, ishte një garë personale gjë të cilën në atë kohë e kisha shumë të nevojshme ta ndërmerria. E them garë personale sepse periudha në të cilën zhvilloheshin xhirimet e emisionit ishte një periudhë që njeriu im i jetës nuk e shikonte të duhur vazhdimësinë time në industrinë e Mikpritjes dhe Turizmit, ndërkohë që unë doja të ftoja gjithë botën në këtë industri", tregon historinë e saj Dorinela, e cila ta përcjell pasionin për profesionin edhe nëpërmjet një bisede.

Megjithatë, asgjë nuk mundi të ndalë pjesëmarrjen e saj në emisionin "Më i Miri në Vend", i cili i mundësoi asaj ëndrrën.

Mbaruan xhirimet. Dorinela u shpall zyrtarisht fituesja e edicionit të katërt në "Më i Miri në Vend". "Kisha fituar një garë ku përballë kisha profesionistë të fushës, kisha fituar një kupë që për mua në mënyrë të pashpjegueshme më jepte një emocion që nuk do arrija dot ta shpjegoja kurrsesi me fjalë. Në të njëjtën kohë kisha fituar me shumë krenari garën më të madhe me veten dhe atë me njeriun e shtrenjtë të jetës. Ishte dashur pjesëmarrja tek ky emision, që im shoq të kuptonte rëndësinë e vërtetë të këtij profesioni tek unë. Ai kishte parë sesi përjetoja çdo xhirim, sesi shpjegoja çdo emocion që përjetoja dhe me sa pasion flisja për një të ardhme në të cilën tanimë unë përkisja, Hotelieri-Turizëm".

Pse e quajti pikënisje emisionin në fillim të rrëfimit të saj?

Dorinela shpjegon me pasion se i kishte vënë synim vetes që të mësonte me shumë profesionalizëm dhe pasion punën për të cilën i qeshte fytyra dhe zemra. Edhe pse në pritje të ëmbël, pasi fitoi, Dorinela entuziazmin e ktheu në një projekt për të ardhmen, mori nismën për të qenë sipërmarrëse e një biznesi të vogël me aspirata për t'u bërë biznesi i madh në të ardhmen. Fundi i kësaj historie për Dorinelën, që nisi me mungesë besimi nga bashkëshorti i saj, me një shtatëzani që nuk e konsideroi pengesë asnjë ditë në xhirime, përfundoi në një bashkim të lumtur pasionesh "...bashkëshorti të kulinarisë, ndërsa unë atë të menaxhimit dhe marketingut dhe të dy drejtojmë sot një restaurant-hotel në zonën më të bukur turistike të Durrësit, në Currila. "VILLA D" do të quhej restoranti ynë, D si dashuria që na lidhte për njëri-tjetrin dhe profesionin që po ushtronim, D si inicalet e emrave tanë (Dorinela dhe Denis) dhe D si forma që po merrte barku im në këtë periudhë"- qesh Dorinela romantike. "Me gjithë këto që ju tregova, a mund t'ju them tani me plot gojën që pjesëmarrja tek "Më i Miri në Vend" më ndryshoi jetën?", e mbyll rrëfimin e lumtur, pasi sot ajo i ka dhënë jetë të gjitha ëndrrave të saj.

Rruga drejt karrierës që dëshirojmë nuk është gjithmonë një vijë e drejtë, përkundrazi shpesh ky rrugëtim është sfidues dhe me ulje-ngritje, por historia e Dorinelës na tregon se përherë ia vlen të luftojmë për të, dhe për të ardhmen që duam të ndërtojmë për veten tonë.

